



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.330/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët : Bujar Muzaqi - kryesues, Kujtim Pasuli, dhe Ramush Bardiqi - anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Subjektit Politik Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës (IRDK), me seli në Komuna Pejë, parashtruar kundër Subjektit Politik Partia Liberale Egjiptiane (PLE) me seli në Komuna Fushë Kosovë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09 Shkurt 2025, në seancën e panelit të mbajtur me 05.02.2025, mori këtë :

V E N D I M

HEDHET E PAS AFATSHME ankesa e Subjektit Politik Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës (IRDK), me seli në Pejë, Anr.330/2025, e datës 03.02.2025, paraqitur kundër subjektit politik Partia Liberale Egjiptiane (PLE), me seli në Fushë Kosovë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09 Shkurt 2025,

A r s y e t i m

Me datë 03.02.2025 PZAP-i, ka pranuar ankesën Anr.330/2025 nga Subjekti Politik Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës (IRDK) më të cilën pretendohet se PLE me datë 25.01.2025 në Komunën e Obiliqit përkatesisht shkollën "Pandeli Sotiri", Plemetin, ka mbajtur tubim zgjedhor me qytetarë të Obiliqit me fshatra. Gjatë këtij tubimi përkatesisht intervalit kohor mes 15:00 dhe 16:00, në mesin e qytetarëve prezentë në tubim ka pasur edhe femijë qartazi nën moshën 15 vjeçare ashtu që subjekti PLE me këtë rast gjatë tubimit përkatesisht fushatës zgjedhore ka kryer shkelje të nenit 5, paragrafi 3, të Regullorës zgjedhore nr 07/2025-Fushatë e Zgjedhjeve, monitorimi i fushatës së zgjedhjeve de deklarimi financiar. Duke angazhuar persona nën moshën pesëmbëdhjetë (15) vjeç në fushatë zgjedhore.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkngjitur fotot dhe video CD nga tubimi në fjalë.

Në përgjigje në ankesë të paraqitur me datë 05.02.2025, subjekti politik PLE e ka kundërshtuar ankesën me pretendimin se e njëjta është paraqitur pas afatit ligjor sepse në ankesë thuhet se PLE ka organizuar tubimin me datë 25.01.2025 ndërsa ankesa është paraqitur me datë 03.02.2025 që i bie 8 ditë pas.

Po ashtu sa i përket pretendimit të parashtruesit të aneksës se ka pasur persona nën moshën 15 vjeçare në tubimin e PLE ky pretendim nuk qëndron pasi që PLE ka identifikuar të njëjtit dhe ata janë Zejnepe Gashi dhe Yllnaz Jashari i moshës mbi 16 vjeçare dhe për të cilin për pjesëmarrjen e tij në tubim ka dhenë pëlqim prindi i tij.

Parashtruesi i përgjigjies në ankesë si provë ka bashkangjitur: Leternjoftimet dhe Çertifikatat e dërguara personalisht dhe nga prindi i tij.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës, konstatoi se :

-Ankesat janë të pasafatshme.

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të ankesës ka gjetur se ankesa e parashtruar nga Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës, me seli në Komuna Pejë, kundër subjektit politik Partia Liberale Egjiptiane (PLE) e datës 03.02.2025, është parashtruar pas afatit ligjor të përcaktuar me dispozitën ligjore të nenit 39 paragrafi 3 i LZP-së, në të cilin nen në mënyrë decisive thuhet se: *“Personi i cili ka interes ligjor në një çështje brenda juridiksionit të PZAP-it, ose të drejtat e të cilit janë shkelur për sa i përket shkeljeve të pretenduara të Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët gjatë periudhës së fushatës zgjedhore dhe ditës së zgjedhjeve, mund të paraqes ankesë në PZAP brenda dyzet e tetë (48) orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar, dhe PZAP-i, do të vendos për ankesën brenda shtatëdhjetë e dy (72) orëve nga koha e pranimit të saj, si dhe në nenin 13, paragrafi 3, nen paragrafi 3.3 i Rregullores Nr.01/2024 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosijes së Ankesave të PZAP-it, në të cilin nen në mënyrë decisive thuhet se “PZAP-i e hedhë ankesën kur vlerëson se ajo nuk përmbush kërkesat e LZP-së dhe kësaj rregullore për shqyrtim, nën paragrafi 3.3. nuk është dorëzuar në afatin e paraparë ligjor”*

Në këtë rast, nga shqyrtimi i shkresave të lëndës, konstatohet se parashtruesi i ankesës ka dorëzuar ankesën në PZAP, më datë 03.02.2025, në të cilën ka pretenduar se me datë 25.01.2025 në Komunën e Obiliqit përkatësisht në shkollën “Pandeli Sotiri”, Plemetin, PLE ka mbajtur tubim zgjedhor me qytetarë të Obiliqit me fshatra. Gjatë këtij tubimi përkatësisht intervalit kohor mes 15:00 dhe 16:00, në mesin e qytetarëve prezentë në tubim ka pasur edhe fëmijë qartazi nën moshën 15 vjeçare që është në kundërshtim me nenin 5, paragrafi 3 i Rregullorës Zgjedhore nr 07/2025i cili përcakton, *“Asnjë subjekt politik i certifikuar nuk mund të angazjojë persona nën moshën 15 vjeç në fushatën zgjedhore. Pjesëmarrja e fëmijeve në fushatën zgjedhore, nuk mund të behët pa prezencën apo pëlqimin e prindërve.*

Megjithatë, ankesa është paraqitur pas afatit ligjor për paraqitjen e ankesave, sipas nenit 39, paragrafi 3 i LZP-së, ku afati për dorëzimin e ankesave është 48 orë nga ndodhja e shkeljes së supozuar, dhe ankesa është dorëzuar më 03.02.2025, ndërkohë që shkelja në fjalë është bërë më datë 25.01.2025, që do të thotë se ankesa është dorëzuar pas afatit të paraparë ligjor.

Paneli konstatoi se ankesa është ushtruar pas afatit ligjor, dhe nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të nenit 39 paragrafi 3, nenit 115 paragraf 1 i LZP-së, dhe nenit 9 paragrafi 5 nën paragrafi 5.5 të Rregullorës 01/2025, për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosijes së Ankesave, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

Anr. 330/2025 më datë 05.02.2025

**Kryesues i Panelit,
Bujar Muzaqi**



KËSHILLA JURIDIKE: *Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.*